



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.10.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik ALBKOS SAFETY SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me çanta shpinore për shuarjen e zjarrit", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-9900-1-3-6, Nr. i brendshëm-632-24-112-136, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik ALBKOS SAFETY SH.P.K, e dt.14.10.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me çanta shpinore për shuarjen e zjarrit", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-9900-1-3-6, Nr. i brendshëm-632-24-112-136, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 08.10.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 08.10.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anuloj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik ALBKOS SAFETY SH.P.K me dt.14.10.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me çanta shpinore për shuarjen e zjarrit", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-9900-1-3-6, Nr. i brendshëm-632-24-112-136.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, ka vendosur që të bëj anulimin e aktivitetit të prokurimit "Furnizimi me çanta shpinore për shuarjen e zjarrit", Nr. i prokurimit- 632-24-9900-1-3-6, Nr. i brendshëm-632-24-112-136, sepse të gjithë Operatorët ekonomik pjesëmarrës kanë qenë të papërgjegjshëm dhe nuk kanë plotësuar kërkesat e Autoritetit Kontraktues në FDT-ç.

Ju si Operator ekonomik, keni ofruar katalogun e kompanisë Lestech, por në këtë katalog në faqen 2, specifikimet teknike nuk janë siç janë kërkuar në dosje të tenderit, prandaj pretendimet e juaja nuk qëndrojnë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit